



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

**Neni 1
Formimi i Komisionit dhe përbërja**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të cilat i parashtrihen Kryetarit të Komunës për mbështetje financiare për renovimin apo ndërtimin e shtëpive për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike.

Komisioni formohet në përbërje si vijon:

- 1.Hasan Zeqiri, Zyra e Kryetarit të Komunës, Kryesues
- 2.Ymer Bikliqi, Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
- 3.Agim Krasniqi, Drejtorati për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale, anëtar

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrë e Komisionit është të bëjë konstatimin e gjendjes faktike në teren me procesverbal dhe foto të bashkëngjitura dhe të nxjerr Rekomandim për Kryetarin e Komunës përkitazi me kërkesat e parashtruara.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 400-10147
Lipjan, më 07.03.2017

